



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES  
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

Nr. 970 Prot.

Vau Dejes me 25.02.2022

**NJOFTIM PËR DËGJESË PUBLIKE**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18 pika 1 dhe pika 2 , neni 54 germa (e) dhe në rregulloren e brendshme për funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës (VKB 23/2020) neni 154:

Këshilli Bashkiak Vau Dejës fton të gjithë banorët e fshatit Karmë, Njesia Administrative Vau Dejës të bëjnë sugjerimet e tyre lidhur me projekt vendimin e meposhtëm:

**“Për dhënien në përdorim me afat 9 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 4.4 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje(kende lojërash, mjedise sportive, shlodhëse etj) dhe bën pjesë në ngastrat nr.6 dhe nr.17 në ekonominë pyjore Karmë”**

( Paraqitur nga Drejtoria e pyjeve, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit-sektori menaxhimit të pyjeve dhe kullotave)

Dëgjesa publike do të bëhet me datë 24.03.2022 ora 10.00 në Fshatin Karmë, Njësia Administrative Vau Dejës, duke respektuar masat anti Covid

Gjithashtu ju ftojmë të bëheni pjesë e dëgjësës për projekt vendimin e mësipërm, nëpërmjet sugjerimeve tuaja në adresat elektronike:

([info@vaudejes.gov.al](mailto:info@vaudejes.gov.al) , [ardian.celepija@vaudejes.gov.al](mailto:ardian.celepija@vaudejes.gov.al) , facebook – Këshilli Bashkiak Vau Dejës ).

**SEKRETARI KËSHILLIT**

**Ardian CELEPIJA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT**  
**Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave**

Nr. 38 prot.

Vau Dejës, më 28.01.2022

**Lenda: Dërgim Dokumentacioni për Miratim**

**Këshillit të Bashkise Vau Dejës**

Në zbatim të detyrimeve që dalin nga ligji Nr.139/2015“Për vetqeverisjen Vendore“,ligjit Nr.57/2020,datë 30.04.2020“Për pyjet“ bashkëlidhur po ju dërgojmë projekt vendimin **nr.7,datë 28.01.2022**“ Për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor **për qëllime pushimi,argëtimi,shëndetësore,shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash,mjedise sportive,shlodhësë etj)** .

**Bashkelidhur projekt vendimit jepen:**

1. Raporti mbi studimin tekniko-ekonomik për dhënie në përdorim nga fondi pyjor të sipërfaqeve në pronësi publike të bashkisë Vau Dejës.
- Relacioni i hartuar nga Sektori i Menaxhimit të pyjeve e Kullotave **nr.09 Prot.datë 28.01.2022**.
- Harta e ngastrës pyjore për sipërfaqen që do të jepet me qira.

**Ju faleminderit**

**Konceptoi: Mark Suli**

**Miratoi: Rrok Ftoni**

**KRYETARI**  
**MARK BABANI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES**  
**DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT**  
**Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave**

**PROJEKT V E N D I M**

Nr. 07, datë 28.01.2022

“Për dhënien në përdorim me afat 9 vjecar sipërfaqen pyjore prej 4.4 ha për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj)”, dhe bën pjesë në ngastrat nr.6 dhe 17 në ekonominë pyjore Karmë.

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” pika nr 2 germa (a) dhe pika 7 të Udhëzimit nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrisë së Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” ,i propozojmë **Këshillit të Bashkisë Vau Dejës**, ku në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_2022 të **Këshillit të Bashkisë** të:

**V E N D O S I**

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes në total 4.4 ha për qëllime pushime argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj)” dhe bën pjesë në ngastrat nr.6 me sipërfaqe 3.6 ha dhe 17 me sipërfaqe 0.8 ha në ekonominë pyjore Karmë.

, sipas listës së inventarit, **shtojca nr.47** dhe janë në pronësi/administrim të Bashkisë Vau Dejës.

2. Afati i dhënies me qera të jetë 9 (nente) vjet.

3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jete sipas VKM nr.1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Konceptoi: **Z. Ujka**

Konceptoi **Bazën Ligjore K. Shtatri**

Miratoi: **Rr. Ftoni**

**KRYETARI**  
**MARK BABANI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT**  
**Sektori i Menazhimit të Pyjeve dhe Kullotave**

Nr. 09 prot.

Vau Dejës, më 28.01.2022

**RELACION**

**Për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj”**

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës**

**Të nderuar këshilltarë,**

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku në piken 5 të këtij neni përcaktohet: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:**

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020 “Për pyjet “, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.2 c , **neni 54 pika el neni 18**, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat , procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” pika 7.

*Siperfaqja e marrë në studim do tëdale në ankand nëpërmjet procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit ne fuqi.*

**Siperfaqja që planifikohet të jepet në përdorim është 4.4 ha.**

Në funksion të siperfaqes që merret në përdorim, sipas VKM-së nr.1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për

percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” lidhja 2 pika 5/3 dhe pika 5/6, si me poshtë.

5. Për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampinge (kënde lodrash, mjedise sportive, shlodhëse etj.)				
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet
1	Pyll trungishte	180 000	120 750	100 000
2	Pyll cungishte	126 000	90 000	75 000
3	Pyll shkurre	126 000	90 000	<b>75 000</b>
4	Kullota	126 000	90 000	75 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	90 000	52 000	45 000
6	Inproduktive	90 000	52 000	<b>45 000</b>

Vlera totale e pagesës/vit është 306 000 (tre qind e gjashtë mije) lekë.

Bazuar në sa më sipër, propozojmë miratimin e dhënies në përdorim me qera të sipërfaqes prej 4.4 ha .

Bashkëlidhur po ju dergojmë.

**1.Dokumentacionin e plote dhe hartën e ekonomisë pyjore.**


Duke ju falënderuar, ju ftojmë në miratimin e projekt vendimit.

Specialistet

Ing.Mark Suli



Ing.Esmeraldo Harapi



Ing.Zeqir Ujka



Miratoi

Drejtori

Rrok Ftoni



**RAPORT**

**MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM/HEQJE NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË VAU DEJËS**

**“PËR QËLLIME PUSHIMI, ARGËTIMI, SHENDETSORE, SHOQERORE DHE PËR VËPRIMTARI TURISTIKE ,KAMPINGJE (KËNDE LOJRASH,MJEDISE SPORTIVE,SHLODHËSË ETJ”**

Bazuar në Urdhërin nr.5, datë 12.01.2022 të Kryetarit të Bashkise për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënie të fondit pyjor me qira “për qëllime pushimi, argëtimi, shendetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj”

Grupi i punës i përbërë nga z.Zeqir Ujka ,Pergjegjes i sektorit te pyjeve z. Mark Suli, specialist i administrimit të pyjeve ,z.Esmeraldo Harapi specialist kadastrë nga data 27.01.2022 deri në datën 28.01.2021 ,realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqes kullimore me objekt dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore 4.4 ha “për qëllime pushimi, argëtimi, shendetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj”.

Mbështetur në të dhënat e regjistrin kadastral pyjor/kullor sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/Bashkive, rezulton që sipërfaqja e kërkuar që merret në përdorim është 4.4 ha për qëllime pushimi argëtimi, shëndetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj” dhe bën pjese në ngastrat nr.6 me sipërfaqe 3.6 ha dhe 17 me sipërfaqe 0.8 ha në ekonomine pyjore Karme, sipas listës së inventarit, shtojca nr.47 dhe janë në pronësi/administrim të Bashkise Vau Dejës.

Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: (sipas tabelave përkatëse Bashkelidhur).

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga “Kujtim Pjetri jepen në përdorim për një afat 9 prej vjet një sipërfaqe prej 4.4 ha për qëllime

**pushimi, argëtimi, shendetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj”**

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në V.K.M-ve nr. 1353, datë 10.10.2008, të ndryshuar “Përrregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, në VKM-ve nr 1374, date 10.10.2008, të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”. Udhëzimin e Ministrit te Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” pika nr 2 gërma (a) dhe 7.

*Siperfaqja e marre në studim do të dale në ankand* nëpërmjet procedurës së Konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.

Pas miratimit të raportit tekniko - ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, kryetari Bashkise nxjerr urdherin për përgatitjen e dokumentave të ankandit nëpërmjet procedurës së konkurimit publik

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-venë nr.1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” lidhja 2 pika 5/3 dhe 5/6, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit. **Shuma në lekë/vit konsiston në:**

**1. Vlerën e përdorimit lekë/ha/vit**

- a) Ngastra nr. 6 ,shkurre prej 3.6 ha x 75 000 lekë = **270 000** lekë
- b) Ngastra nr. 17 ,Shkëmbore(inproduktive) prej 0.8 ha x 45 000 lekë = **36 000** lekë

**Në total 306 000 (tre qind e gjashtë mije) lekë**

**PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK**

Ing. Zeqir Ujka



Ing. Mark Suli



Ing. Esmeraldo Harapi



**KRYETARI**

**MARK BABANI**

Bashkia Vau Dejës

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR

( sipas regjistrimit kadastral)

Për qëllime shoqërore, pushime , argëtimi, etj  
Formulari nr.1

ID.	Ekonomia Pyjore	Parcela	Sip. Tot. ha	Perberja grumbullit	Funksion i	Forma Qeverisjes	Mosha	K.D	Te dhena te grumbullit pyjor				Fuqia lendore		
									D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli	Kat et	Per ha	Total
SH34 00 006	Karmë	6	79.66	Shkozë	prodhues	shkurre	40	0.8	4	5	0	0	N	52	4207
SH34 00 017	Karmë	17	3.56	Shkembore(i nproduktive	shkembor	shkembore	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Gjithsejt</b>			<b>83.22</b>				<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>52</b>	<b>4207</b>

PASQYRE E PERSHKRIMIT PARCELAR

( sipas verifikimit ne terren)

Për qëllime shoqërore, pushime , argëtimi, etj  
Formulari 2

ID.	Ekonomia	Parcela	Sip. Tot.	Perberja grumbullit	Funksion	Forma Qeverisjes	Mosha	K.D	Te dhena te grumbullit pyjor				Fuqia lendore		
									D mes	Lart. mes	Filizeria	Nen pylli	Kat et	Per ha	Total
SH34 00 006	Karmë	6	79.66	Shkozë	prodhues	shkurre	40	0.8	5	6	0	0	N	62	4950
SH34 00 017	Karmë	17	3.56	nproduktive	shkembore	shkembore	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Gjithsejt</b>			<b>83.22</b>											<b>62</b>	<b>4950</b>

**PLOTESOI:**

Ing. Mark Suli



Ing. Zeqir Ujka



Ing. Esmeraldo harapi





Bashkia Vau Dejës

**TABELA PERMBLEDHËSE E VLERESIMIT FINANCIAR**  
**Për qëllime shoqërore, pushime , argëtimi, etj**

Formulari nr.4

Perdorimi I territorit	Sip ha	Bashkia	Volumi ne m <sup>3</sup> sipas asortiment eve	Sasia	Vlera Leke /m3	Shuma I	Gjatesia e perdorimit rruge ne km	Tarifa dhenje ne perdorim lek/ha/vit			Shuma II	Totali I+II
								1	2.-5	6.-10		
0	1	2	3		4	5	6	8	9	10	11	12
Pyll shkurre	3.6	V.Dejës	0	0	0	0	0	126 000	90 000	75 000	270 000	270 000
Shkembore(fin produktive)	0.8	V.Dejës	0	0	0	0	0	90 000	52 000	45 000	36 000	36 000
<b>Gjithsejt</b>	4.4				0	0	0				0	306 000

**LISTA E NGASTRAVE TË FONDIT PYOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË HIQEN/JEPEN NË PËRDORIM**  
**Per qellime shoqerore,pushime ,argetimi.**

Formulari 5

Nr.	ID Prone	Ekonomia Pyjore/kull osore	Ng/neng,n r.	Siperfaqie qe hiqet nga fondi pyjor/kullor or	Siperfaqia Gjatesia ne perdorim km		Tubacion/ kanal	
					Siperfaqie qe jepet ne perdorim nga fondi pyjor/kulloso	Rruge km		Linje
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1	Sh34 00 6	karmë	6	0	3.6	0	0	0
2	SH34 00 011	Karmë	17		0.8			
<b>Shuma</b>					<b>4.4</b>			

**PLOTESOI:**

Ing.Mark Suli



Ing. Zeqir Ujka



Ing. Esmeraldo harapi



# Ekonomia Pyjore Karmë SH 1:10 000

